



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:182395
Datë: 06.12.2024
Numri i dokumentit: 06560537

Ac.nr.3554/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Rafet Haxhaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.K. nga fshati M., Komuna e P., të cilin me autorizim e përfaqëson A. H., avokat nga P., lagjia H., Rr.”N.K.” nr., Hy-..., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.M., për shkak të kompensimit të shujtave për ditët në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3011/22, të datës 21.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3011/22, i datës 21.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.3011/22, i datës 21.03.2023, ka vendosur si vijon: *“I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. K. nga fshati M., komuna e P.. II.DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësit M.K., në emër të shujtave ditore për 190 ditë të pranisë në punë prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2021, të i'a kompensojë shumën prej 380.00 € (treqind e tetëdhjetë euro), dhe atë me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (06.09.2022) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm. III.DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 124 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm...”*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit

të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe të prishet aktgjykimi, dhe të hedhet poshtë padia e paditësit, të ndryshohet ose të prishet aktgjykim dhe të kthehet në rivendosje në Gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi, me datë 06.09.2022, ka ushtruar padi për kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale për Arsim në Prizren.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, si dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në bazë të nenit 152 të LPK-së, (pa shqyrtim kryesor të çështjes), ka nxjerrë aktgjykim C.nr.3011/22 datë 21.03.2023, me të cilin ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se gjykata përmes kontratës së punës me nr.protokoli 53/15, të datës 01.12.2015 dhe në bazë të vërtetimit me nr.ref. 16/22, të datës 19.10.2022 të lëshuar nga e paditura vërtetoi faktin se paditësi, është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht -mësimdhënës në Sh.F.M.U “Brigada 125”, në M., Komuna e P. dhe gjatë vitit 2021 i njëjti ka punuar gjithsej 190 ditë pune. Gjykata ia ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021. Për kamatën ka vendosur bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditësit dhe nuk ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në SH.M.L.P “Brigada 125”, në Prizren. Ndërsa nga vërtetimi 16/22, të datës 19.10.2022 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësi, në vitin 2021 ka prezantuar në punë gjithsej 190 ditë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve, (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASh, SBAShK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023“*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit

në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: “*Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...*”, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së dhe llogaritja është bërë saktë në përputhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kamatën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3554/2023, datë 04.12.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.